

VENDIM
Nr. 302, datë 10.5.2019

PËR KRITERET E USHTRIMIT, TË MIRATIMIT E MONITORIMIT
TË VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-SHKENCORE
NË ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

(Ndryshuar me VKM-në nr. 523, datë 1.8.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 81, datë 4.5.2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore.

2. Ushtrimi i veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për biodiversitetin, faunën e florën e egër dhe zonat e mbrojtura.

3. Kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore mund të paraqitet nga subjektet/individët, si më poshtë vijon:

- a) institucionet e arsimit të lartë;
- b) institucionet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit;
- c) institucionet e kërkim-zhvillimit pranë ministrive;
- ç) OJF-të e specializuar në këtë fushë;
- d) studiues/hulumtues;
- dh) studentët vendas apo të huaj;
- e) çdo person tjetër i interesuar në fushën e kërkimit shkencor.

4. *Subjektet/individët, të cilët kërkojnë të ushtrorjnë veprimtarinë kërkimore-shkencore, dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” kërkesën për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).*

5. Kërkesa shoqërohet nga tre shtojca, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi:

- a) shtojca nr.1, që pasqyron detaje mbi aplikuesin/t;
- b) shtojca nr.2, që pasqyron detajet mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- c) shtojca nr.3, vetëdeklarimi.

6. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, nga data e dorëzimit, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) kapacitetet shkencore dhe studimore të subjekteve/individëve, të përcaktuar në pikën 3, të vendimit;

b) eksperiencën në fushën e studimit, për të cilën aplikohet;

c) dokumentin që vërteton se aplikuesi është student dhe qëllimi i kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore është në kuadër të ndjekjes së programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë e të tretë;

ç) në rastet e aplikimit të personelit akademik, ky i fundit duhet të paraqesë dokumentin nga punëdhënësi i tij, që vërteton se aplikuesi është personel akademik;

d) kërkesat e përcaktuara në shtojcat nr. 1 e nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. *Në rast se nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura konstatohet se kërkesa e paraqitur nga subjekti kërkues/aplikuesi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar “e-Albania”, duke i kërkuar subjektit kërkues/aplikuesit për të bërë plotësimet e nevojshme brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, qubet se nuk është regjistruar. Kërkesi njoftohet përmes portalit unik qeveritar “e-Albania” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera, dokumente me vullë*

elektronike. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura vendos për miratimin ose jo të kërkesës brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i këtij afati.

8. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, gjatë shqyrtimit të kërkesës së subjektit për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, mban në konsideratë planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur përkatëse, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, si dhe kuadrin ligjor në fuqi për trashëgiminë kulturore.

9. Në rast se në zonat e mbrojtura mjedisore, ku do ushtrohet veprimtaria kërkimore-shkencore, përfshihen objekte apo zona të trashëgimisë kulturore, merret edhe mendimi i ministrisë përgjegjëse për kulturën.

10. Pas shqyrtimit të kërkesës nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe pasi ajo e gjen atë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit, të faunës e florës së egër, zonave të mbrojtura dhe kërkesat e këtij vendimi, kjo e fundit miraton të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore. *Njoftimi për miratimin apo refuzimin e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.*

11. Në rastet kur kërkesa bëhet për zonat, të cilat janë përcaktuar si qendra historike, zona arkeologjike dhe zona të mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura njofton ministrinë përgjegjëse për kulturën për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

12. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura njofton ministrinë përgjegjëse për mjedisin, administratën rajonale të zonave të mbrojtura (AdZM) dhe bashkinë përkatëse, brenda territorit administrativ të së cilës ndodhet zona e mbrojtur, për të drejtën e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

13. Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, shoqërohet nga stafi i AdZM-së dhe rangersat e zonës së mbrojtur mjedisore ku kryhet veprimtaria. Në rast se stafi i AdZM-së dhe rangersat konstatojnë shkelje në veprimtarinë kërkimore-shkencore, AdZM-ja ushtron kompetencat në përputhje me pikën 4, të neni 66, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.

14. Monitorimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore kryhet në përputhje me kushtet e kërkesës së miratuar dhe përfshin këto elemente bazë:

a) respektimi i kushteve të vëna në planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur;

b) metodologjia e studimit, llojet dhe organizmat biologjikë, sasia e kampionimit dhe shpeshësia e daljes në terren të jetë e njëjtë me ato në shtojcat nr. 1 e nr. 2, të cilat janë miratuar sipas kërkesës së subjektit;

c) verifikimi i mjeteve dhe pajisjeve të përdorura nga subjekti gjatë procesit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, siç janë deklaruar në metodologjinë e studimit të përcaktuar në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

15. Në përfundim të ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, aplikuesit i lind detyrimi që të përmbushë kërkesat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit, të faunës e florës së egër dhe zonave të mbrojtura. *Konkretisht, aplikuesit dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” raportin përkatës me rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.*

16. Tarifa e hyrjes për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore llogaritet sipas aktit nënligjor për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre, që autorizon ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.

17. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura mban dhe administron regjistrin e kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, sipas formatit të miratuar me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës dhe i dokumentacionit për miratimin e ushtrimit të veprimtarive kërkimore-shkencore, si dhe i raportit mbi rezultatet e arritura gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
FORMULARI I APLIKIMIT

KËRKESË
PËR TË DREJTËN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE
KËRKIMORE-SHKENCORE NË ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE

DETAJE TË APLIKUESIT/APLIKUESVE (zgjidh opsionin)

1.1 Emër Mbiemër	1.1.1 Titulli:
1.2 Institucioni:	
1.3 Adresa:	1.3.1 Kodi postar:
1.4 Nr. i telefonit/ e-mail:	
1.5 Lista e anëtarëve të stafit pjesëmarrës në studimin kërkimor-shkencor:	
1.6 Titulli i studimit/ projektit:	
1.7 Kordinatat gjeografike të zonës:	
1.8 Përshkrimi i shkurtër i projektit:	
1.9 Metodologjia e studimit/ projektit:	

1.9.1 Fillimi dhe mbarimi i projektit:

SHTOJCA NR.3

VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari _____

(emër atësi mbiemër)

i datëlindjes _____

(datë/muaj/vit)

Nëse aplikanti përfaqëson një institucion duhet të saktësojë pozicionin që mban

-
1. Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se mbaj përgjegjësi personale për të gjithë informacionin që është plotësuar në këtë formular dhe se veprimtaria e kerkimit shkencor nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të prishjes së ekuilibrave natyrorë dhe se mbas përfundimit të projektit do të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë Kombëtare të zonarve të mbrojtura rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.

Deklaruesi

Firma

Datë

___ / ___ / ___